



Education International
Internationale de l'Éducation
Internacional de la Educación
Bildungsinternationale



THIRRJE PËR MINISTRAT E PROCESIT TË BOLONJËS

Për Konferencën e Ministrave në Tiranë, Maj, 2024

Komiteti i Sindikatave Evropiane të Arsimit (ETUCE) është një federatë prej 127 sindikatash arsimi nga 51 vende, dhe që përfaqësojnë gjithsej 11 milion anëtarë në të gjithë Evropën. Është Rajoni Evropian i Sindikatës Ndërkombëtare të Arsimit. ETUCE është anëtare konsultative e Bologna Processes' Bologna Follow-Up Group.

Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës – FSASH dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë – SPASH janë anëtare të ETUCE dhe përfaqësojnë 20,000 mësues dhe staf ndihmës në sektorët e arsimit shqiptar.

Tranzicioni digital dhe ai i gjelbër, krizat shëndetësore dhe të kostos së jetesës, ndryshimet demografike, sulmet ndaj vlerave themelore si të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit dhe demokracia, liria dhe respekti për dijen dhe shkencën, dhe lufta e Rusisë kundër Ukrainës dhe reziku i përshkallëzimit të saj po shkaktojnë një ndikim të fortë social, ekonomik dhe politik në zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe personelin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Sektorët e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Evropë dhe personeli i tyre kanë një rol kyç në mbrojtjen e vlerave themelore të arsimit të lartë, të drejtave të njeriut, demokracisë dhe barazisë, duke i transmetuar këto vlera nga brezi në brez dhe duke ndërtuar ura midis kombeve. Liria akademike dhe autonomia institucionale janë shtylla vitale e demokracive të forta dhe zhvillimit shoqëror. Liria akademike është thelbësore për çdo demokraci për të mundësuar lirinë e shprehjes dhe diskutimet e hapura dhe kritike, për të ndërtuar besimin e ndërsjellë dhe për të krijuar një zhvillim të qëndrueshëm. Mësimdhënia në sektorin e arsimit të lartë dhe kërkimi shkencor, të lira nga ndikimi politik, ekonomik dhe fetar ndihmojnë për të garantuar një shoqëri të bazuar në dije, ku njerëzit marrin vendime racionale dhe të arsyeshme si qytetarë dhe gjithashtu marrin pjesë aktive në proceset demokratike.

Në mënyrë që të garantohet arsimi dhe kërkimi shkencor cilësor dhe të zhvillohet "një Zonë më gjithëpërfshirëse, inovative, e ndërlidhur dhe elastike Evropiane e Arsimit të lartë (EHEA)"¹, është e rëndësishme që stafi të vlerësohet dhe mbështetet siç duhet.

¹Komunikata EHEA e Ministerialit të Romës, 19 Nëntor 2020
http://www.ehea.info/Upload/Rome_Ministerial_Communique.pdf



Education International
Internationale de l'Education
Internacional de la Educación
Bildungsinternationale



Eshtë e rëndësishme të siguroheni që karriera akademike të jetë tërheqëse për mësuesit dhe studiuesit e talentuar. Megjithatë, presionet në rritje ndaj akademikëve dhe institucioneve të arsimit të lartë, duke përfshirë mungesën e fondeve, privatizimin, kontratat e përkohshme të punës në fushën akademike dhe pagat në rënie, po e bëjnë karrierën akademike jo tërheqëse. Përmirësimi i atraktivitetit të karrierës akademike dhe ruajtja e stafit në arsimin dhe kërkimin e lartë janë prioritetë për Organizatat Anëtare të Komitetit të Sindicatave Evropiane të Arsimit (ETUCE) që përfaqëson stafin në sektorin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në 52 vende.

Në prag të Konferencës Ministrore të vitit 2024 të Procesit të Bolonjës, u bëjmë thirrje Ministrale të angazhohen për synimet e shprehura në Komunikatën e ardhshme:

- Forcimi i lirisë akademike, autonomisë institucionale dhe vlerave të tjera themelore, të tillë si liria për dije, shkencë dhe liria e fjalës, dhe garancia që ato të monitorohen në mënyrë efektive në të gjithë EHEA duke patur në proces dhe përfshirjen e stafit;
- Inkurajimi i bashkëpunimit në vend të konkurrencës ndërmjet institucioneve, stafit dhe studentëve brenda Procesit të Bolonjës;
- Garantimi i financimit dhe investimeve publike të qëndrueshme dhe afatgjata në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor për të siguruar arsim dhe kërkim shkencor me cilësi të lartë dhe një mjedis mbështetës pune dhe nxënie për stafin dhe studentët;
- Sigurimi i mësimdhënies dhe të nxënët cilësor të bazuar në kërkim shkencor, barazisë së vlerësimit midis mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, një zhvendosje nga vlerësimi sasior drejt vlerësimit cilësor të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor dhe vlerësimit të përgjegjshëm, transparent dhe kolegjiale të stafit;
- Forcimi i qeverisjes kolegjiale dhe dialogut efektiv social me sindikatat e stafit akademik, në veçanti në lidhje me tranzisionin digital dhe atë gjelbër të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor dhe ndikimin e tyre në vendet e punës dhe kushtet e punës së stafit;
- Karrierë akademike tërheqëse për personelin shumë të kualifikuar duke garantuar **paga dinjitoze, pensione të drejta, kushte të mira pune, siguri pune me kontrata të përhershme,**



Education International
Internationale de l'Éducation
Internacional de la Educación
Bildungsinternationale



rrugë të besueshme karriere dhe mundësi të barabarta për stafin në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor;

- Sigurimi i **shëndetit dhe sigurisë** së akademikëve dhe studiuesve, dhe ofrimi i mbështetjes efektive për të luftuar desinformimin dhe mbrojtja e tyre nga gjuha e urrejtjes dhe ngacmimi;
- Risitë në mësimdhënie dhe të nxenit, përfshirë **digitalizimin** duhet të mbështeten nga praktikat pedagogjike dhe garantimi i **balancës punë-jetë** për stafin, respektimi i së drejtës së tyre për të mos qenë *online* jashtë orarit të punës **dhe për të punuar në distancë**;
- Respektimi dhe mbrojtja e **pronësisë intelektuale** të personelit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor gjatë zhvillimit të shkencës dhe arsimit të hapur;
- Mbështetje e **akademikëve të rinj** me udhëzime dhe përgatitje cilësore për profesionin, kontrata pa afat dhe mënyra të drejta zhvillimi në karrierë;
- Sigurimi i qasjeve të barabarta në **zhvillimin e vazhdueshëm cilësor profesional** për të gjithë stafin gjatë orarit të punës;
- Sigurimi i **qasjes së barabartë** dhe ndërthyrja e dimensionit social të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor për stafin dhe studentët dhe **barazi në rekrutimin, ruajtjen e vendit të punës, zhvillimin e karrières dhe vlerësimin e stafit akademik.**

Kryetari i FSASH
Isa REKAJ



Presidenti i SPASH
Nevrus KAPTELLI

